

VENDIM
Nr.420, datë 8.4.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.113, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË
QEVERISJES VENDORE, KOMUNA GOLAJ TË QARKUT TË KUKËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.113, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në pikën 1, fjalët “... në përdorim...” zëvendësohen me “... në pronësi...”.
2. Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Golaj

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
494-945	Pyje, kullota, infrastrukturë	Në pronësi